

KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)
në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr.4: Tiranë



ANKUESI

Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Tel : 0697839115 / 0696178916
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË" - BF	

OBJEKTI I ANKIMIT

- Kundërshtimi i Vendimit Nr. 533, datë 18.05.2023 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për Organet Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023" ;**
- Rinumërimin dhe Rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore, Bashkia Belsh dhe miratimi i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave;**
- Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh;**
- Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Belsh, duke mos përfshirë rezultatin e qendrës së votimit nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë.**
- Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi.**

TITULLI I VENDIMIT

Vendimi

"Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për Organet Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023".

Nr.

Datë

533

18.05.2023

- Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Shpalljen fitues për Kryetar të Bashkisë Belsh, z. Arif Faik Tafani, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të



- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Baza Ligjore:

Nenet: Nenet 1, 4/1, 18, 35, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë; Neni 6/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; **Pikat** 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore; Nenet 12, pika 4; 21, pika 1; 33, gërma “ë”; 91; 92; 98, pika 4; 106, pika 1; 113, pika 1; 116, pikat 6/7; 116/1, pika 5; 117, pika 2/3/4; 118, pika 1/2; 122, pika 2/5; 123, pika 4; 123/1, pikat 1 dhe 2; 124, pikat 1 dhe 3; 143, pika 1, gërmat “ç” dhe “d”; 160, pika 1, gërma “a” dhe 2; 161, pika 1 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar; Neni 2 i ligjit 138/2015.

NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN

A. Në lidhje me legjitimimin e palës ankuese

Neni 123/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se KQZ-ja vihet në lëvizje me kërkesë të subjekteve zgjedhore në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për cështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së. Ndërsa, neni 124, pika 1 dhe 3 parashikojnë se çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së që çenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.

Me Vendimin Nr. 179, datë 18.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023, Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, me Kryetar z. Ilir Metaj, me shkronjat nistore “BF”.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

Neni 12, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim “KAS”) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma “a” parashikon se KAS-i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, pika 5 parashikon se vendimet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.

Me Vendimin Nr. 533, date 18.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Belsh. Në zbatim të nenit 12, pika 5, nenit 21, pika 1, gërma “a” dhe nenit 123, pika 5 e Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor, i legjitimuar sipas parashtrimeve në paragrafët 11 – 13, ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit të KQZ për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit zgjedhor në KAS, brenda afatit ligjor. Në këtë kuptim, Koalicioni “BF” përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 152, pika 2 i




Manskrimi i Ankuesit



Kodit Zgjedhor ka parashikuar një afat të përgjithshëm ankimi 5-ditor kundër të gjitha vendimeve të marra nga KQZ-ja në periudhën 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve deri në përfundimin e shqyrtimit administrativ të ankimeve. Ndërsa, neni 124, pika 3 ka parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit në për kandidatët për Kryetar Bashkia Belsh mund të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.

Në rastin konkret, vendimi Nr. 533 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është shpallur në datën 18.05.2023. Për respektimin e afatit ligjor, subjekti zgjedhor duhet të paraqesë një ankim jo më vonë se data 23.05.2023. Ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga nenet 152, pika 2 dhe 124, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, Koalicioni “BF” përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.

Konkluzion: Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se siç e kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga Koalicioni “BF” përmbush të tre kriteret proceduriale (*legjitimitimin, kompetencën dhe afatin ligjor*), kërkojmë pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në zonën zgjedhore Bashkia Belsh morën pjesë në zgjedhje **9260** votues. Në datën 15-16 Maj, u krye numërimi i votave për Kandidatët për Kryetar të Bashkisë, proces ky gjatë të cilit u konstatuan parregullsi përgjatë numërimit të votave, të cilat cënuan procesin në atë masë sa KZAZ nr. 45 Bashkia Belsh nuk arriti të merrte vendim për Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Bashkia Belsh dhe të shpallte kandidatin fitues për kryetar bashkie (*kjo sepse me shumicë votash, 4 anëtarë nga 7 të KZAZ shprehën verëjtje dhe mosdakordësi për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve*).

Anëtarët e KZAZ nr. 45, në zbatim të nenit 35, pika 4 të Kodit Zgjedhor i kërkuan KQZ-së marrjen e vendimit. KQZ me vendimin nr. 533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Belsh” miratoi tabelën përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar, Bashkia Belsh, sipas të cilës rezultoi:

- kandidati z. **Arif Tafani**, i mbështetur nga Partia Socialiste ka fituar **4537** vota dhe
- kandidati z. **Bedri Qypi**, mbështetur nga Koalicioni “Bashke Fitojmë” ka fituar **4497** vota

Në përfundim Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpalli kandidatin fitues, z. Arif Tafani me një **diferencë prej vetëm 40 vota**. Por nga të dhënat në tabelën e rezultatit rezultoi se diferenca ndërmjet kandidatëve është disa fish më e vogël se **numri i votave të pavlefshme në këtë njësi i cili është 229 vota**.

Duke qenë se jemi të bindur, bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme, se periudha para dhe zgjedhore u shoqërua me shkelje të ligjit, të cilat cënuan rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikoi drejtpërdrejtë në ndarjen e mandatit, në vijim do të parashtrijmë faktet që mbështesin këtë pretendim:




Nënshkrimi i Ankuesit

Në datën 18.05.2023, kemi marrë dijëni për Vendimin Nr. 533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për Organet Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Koalicioni Bashkë Fitojmë, ka ardhur në dijëni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të procesit zgjedhor të ndodhura në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr. 45 të Bashkisë Belsh.

Duke mos qenë dakord me këtë vendim, për shkak se vlerësojmë se gjatë procesit zgjedhor prej të cilit ka dalë ky vendim kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, si dhe tërësia e shkeljeve të ligjit, të ndodhura në këtë zonë zgjedhore ka cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që ka ndikuar në rezultatin final, siç do të provohen gjatë hetimit administrativ, po parashtrijmë këtë ankim me faktet, dispozitat ligjore dhe arsyetimin ligjor, si më poshtë:

KONTESTIMET GJATË PROCESIT TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT NË QV DHE VNV E KZAZ-SË NR. 45, BASHKIA BELSH:

1. Vëzhguesit e përfaqësuesit të kandidatit për kryetar z. Bedri Qypi kanë pretendime se votat e lexuara në monitore kanë mospërputhje dhe nuk rakordojnë me Proçes-Verbalet e GN-ve për QV-të: 2551/00, 2551/01, 2552/00, 2552/01, 2553/00, 2553/01, 2554/00, 2555/00, 2556/00, 2557/00, 2558/00, 2558/01, 2559/00, 2560/00, 2561/00, 2561/01, 2562/00, 2563/00, 2564/00, 2565/00, 2566/00, 2585/00, 2586/00.

2. QV 2565/01 IIEVP Burgu Kosovë ka pasur mungesë të kamerës dhe pajisjes PEI gjatë procesit të votimit gjë që tregon parregullsinë e votimit të burgosurve dhe mospësigurimin e ruajtjes së fshehtësisë së votimit. Rezultati afërsisht 100% në favor të kandidatit të PS-së bën të dyshimtë se votimi në këtë QV ka qenë i diktuar duke pasur parasysh mungesën e kamerës dhe pajisjes PEI. KZAZ nr.45 bazuar në kërkesën e KQZ-së mbi ngritjen e KQV-së 2565/01 dhe duke u mbështur në verifikimin e të dënuarve në këtë institucion konstatoi se nuk ka banorë të Bashkisë Belsh si dhe duke u referuar zgjedhjeve të mëparshme që ky institucion nuk ka votuar në zgjedhjet vendore ka vendosur me Vendim nr. 3 dt. 25/03/2023 që QV-ja 2565/01 të mos ngrihet në këtë institucion. Por vendimin për ngritjen e kesaj qendre votimi e ka marrë vete KQZ 2 dite para zgjedhjeve, ne mungese të plote transparence si dhe pa garantuar aspak kushtet me minimale të organizimit të një procesi zgjedhor të rregull dhe të drejtë (votim pa kamera, pa pajisje PEI).

3. QV 2565/00 Kosovë pajisja PEI nuk ka funksionuar për 3 orë dhe rrjedhimisht votimi i qytetarëve nuk ka vazhduar gjë që ka penguar pjesëmarrjen në votime. Qytetarë të cilët kanë shkuar gjatë kohës që pajisja PEI nuk funksiononte nuk janë rikthyer më për të votuar.

4. Në QV-në 2556/00 ka pretendime se votimi nuk është bërë i rregullt dhe kanë votuar persona më shumë se 1 në dhomat e votimit.

5. Në QV 2564 Fierzë dhe 2566 Çerragë ka pasur fletë votimi me mungesë të vulës së Kryetarit ose Sekretarit të cilët janë vlerësuar nga GN si të pavlefshme, ku shumica e tyre kanë qenë në favor të kandidatit tonë për kryetar z. Bedri Qypi.

6. Ka pasur fletë votimi të votuara me shkronja ose numra të cilat janë vlerësuar nga GN si të vlefshme gjë që bie ndesh në ruajtjen e fshehtësisë të votës sepse e bën të identifikueshme votën. Psh: kemi konstatuar gjatë numërimit se janë konsideruar vota të vlefshme votat për kandidatin socialist, ku perbri emrit të tij nuk ishte shenja “+” ose “x”, por germa “A”, germa të tjera apo shifra. Keto shenja janë të gjitha të ndaluara dhe lejojnë gjurmimin apo identifikimin e votes, ndaj automatikisht ato duhet të ishin konsideruar si “flete votimi të pavlefshme”, por me forcën e votes, shumica mori vendimet e paligjshme në favor të kandidatit të PS.

7. Dy fletë votimi për kryetar në QV 2551/00 gjatë numërimit ka ndodhur një gabim njerëzor ku ato janë futur poshtë pajisjes së kamerës dhe janë gjetur më vonë pasi është mbyllur kutia. Dy fletët e votimit të



cilat janë të vlefshme dhe i përkasin kandidatit për kryetar z.Bedri Qypi nuk janë pasqyruar në rezultatin përfundimtar për kandidat. Këto dy fletë votimi bashkë me Proçes-verbalin e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e GN-së në momentin e gjetjes ndhodhen në kutinë e veçantë të dorëzuar bashkë me materialet zgjedhore. Kur të hapen kutite, duhet që këto flete të llogariten për kandidatin tonë z. Bedri Qypi.

8. Fletë votimi të cilat janë njollosur me bojë e tamponit të KQV-së gjatë votimit nga GN-të janë vlerësuar si të pavlefshme.

9. Në QV-në 2553/00 një votues ka votuar hapur në favor të kandidatit për kryetar z.Bedri Qypi, kryetari i KQV-së ja ka marrë fletën e votimit dhe ka vendosur shenjë dalluese mbi të dhe më pas e ka futur në kutinë e votimit duke e nxjerrë të pavlefshme fletën e votimit dhe sipas ligjit nuk i ka dhënë fletë të dytë qytetarit për të votuar vullnetin e tij.

10. Në GN-të nga subjekti PS ka pasur persona të cilët janë në marrëdhënie pune me kandidatin e PS-se për kryetar z.Arif Tafani, si Arsen Hysa, Avni Shtylla, Albert Hysa, Durjan Musaku.

Theksojmë se krahas këtyre shkeljeve, rezulton se në Belsh ka patur shumë mos-rakordime në numër votash thuajse në çdo tavolinë numërimi.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Të gjitha faktet, indicjet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (madje në disa raste këto shkelje përbëjnë krim zgjedhor) dhe konkretisht:

- Nenet 115, 116, 116/1, 117 dhe 118 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 42 të Vendimit nr.11, datë 25 Mars 2021 të Komisionit Rregullator (rasti i mospërdorimit të PEI-t dhe identifikimit manual pa vendim të KZAZ).

Së pari, shkeljet që kanë ndodhur gjatë procesit të votimit dhe të numërimit të votave në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë kanë prodhuar një rezultat të padrejtë dhe të paligjshëm në atë qendër, rezultat i cili nuk duhet të përfshihet në rezultatin dhe tabelën përfundimtare.

Në këtë qendër kanë votuar 29 të burgosur dhe rezultati i kësaj qendre votimi është 25 vota për Kandidatin e partisë qeverisëse (PS) dhe vetëm 4 vota për kandidatin e Opozitës z.Bedri Qypi.

Pavarësisht se nuk kemi ende dijeni nëse janë respektuar ose jo kriteret ligjore mbi bazën e të cilave zgjedhësit rezultonin që në atë ditë të kishin vendbanimin në IEVP Belsh, sipas parashikimeve të ligjit për gjendjen civile, përsëri numri i zgjedhësve që kanë votuar në këtë qendër është 29 edhe pse jemi vënë në dijeni të një numri zgjedhësish të cilët janë lejuar të votojnë në atë qendër, qoftë edhe me vendim gjykatë, por në shkelje të hapur të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe ligjit të dekriminalizimit.

Ligji nr. 10129 datë 11.05.2009, i ndryshuar, “Për gjendjen Civile” parashikon se:

Neni 18

Regjistrimi i vendbanimit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë

1. Për shtetasit që: a) kryejnë shërbimin ushtarak apo kryejnë detyra në Forcat e Armatosura dhe banojnë brenda territorit të njësisë së Forcave të Armatosura; b) kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor; c) qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore, me qëllim kurimin afatgjatë; dhe kur qëndrimi




Nënshkrimi i Ankuesit

në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës.

2. Institucioni përgjegjës njofton zyrën kompetente të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucion i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, me marrjen e njoftimit nga institucioni.

Përsa më sipër rezulton qartë se një shtetas i dënuar, në mënyrë që të konsiderohet me vendbanim në IEVP Kosovë **duhet të rezultojë si i tillë prej të paktën 3 muajsh në këtë institucion në datën 4 Prill 2023**, datë në të cilën është gjeneruar lista përfundimtare e zgjedhësve.

Kjo pasi në bazë të nenit 18 të ligjit të gjendjes civile është mënyra e vetme e përcaktimit të vendbanimit të shtetasit i cili ndodhet në IEVP

Gjithashtu procedura e parashikuar nga Kodi Zgjedhor në nenin 57 tij, sanksionon se:

Neni 57

Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012)

1. Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore.

2. Në rast se zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit ku ka emrin në listën e miratuar. Në rast se zgjedhësi paraqet kërkesë në gjykatë në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet.

Kjo procedurë përsëri është një procedurë që mund të përdoret për zgjedhësit të cilët e kanë vendbanimin në IEVP Belsh, në këtë rast, por për shkak të gabimit të administratës nuk e gjejnë emrin në listën përfundimtare të zgjedhësve të kësaj njësie. Kjo procedurë nga ana tjetër nuk mund të shmanget për të krijuar mundësi që shtetas të cilët nuk e kanë vendbanimin ligjor në këtë njësi të mund të votojnë në atë njësi në shkelje dhe në mashtrim të dispozitave ligjore të ligjit për gjendjen civile dhe ligjit zgjedhor të sipërcituara.

Praktikisht asnjë zgjedhës i dënuar që transferohet në këtë njësi, pas daljes së listës përfundimtare të zgjedhësve nuk mund të votojë një këtë njësi, në rastin konkret IEVP Belsh, qoftë dhe me vendim gjykate, pasi për efekt të ligjit nuk e ka aty vendbanimin. Në këtë rast gjykata duhet të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës për lejim për votim, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 57 të Kodit Zgjedhor.

Sigurisht këto shkelje nuk janë të vetmet pasi nga informacioni që disponojmë numri i shtetasve të cilët janë lejuar të votojnë në këtë qendër me vendime gjykate është më i lartë dhe është kërkuar të evidentohet nga ana jonë me anë të kërkesave, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, por për të cilat ende nuk kemi përgjigje. (bashkëlidhur).



Së dyti - Neni 2 i Ligjit 138/2015 (Ligji i Dekriminalizimit) parashikon qartë se:

Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik

1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga

Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:

a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal;

b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;

c) kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim;

ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.


.....

4. Nuk kanë të drejtën të votojnë dhe të zgjedhin me votim të drejtpërdrejtë kandidatët për deputetë në Kuvend apo në organet e qeverisjes vendore personat që plotësojnë kushtet e parashikuara shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni.

Duke qene se ne si subjekt zgjedhor, kishim indicie se në këtë qendër votimi kanë votuar persona të cilat ndalohet të votojnë sipas dispozitës së sipër cituar për personat e dënuar të cilat kanë votuar në këtë qendër votimi, me shkresën e sipërcituar dt. 18.05.2023, kemi kërkuar informacion zyrtar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për veprat penale për të cilat janë dënuar, por ende nuk kemi marrë përgjigje dhe kërkojmë nga KAS që të evidentohet qartë se cili nga të dënuarit e listës së zgjedhësve të I EVP Belsh ka marrë pjesë në procesin zgjedhor ka patur të drejtë të votonte sipas lejimeve dhe ndalimeve të ligjit të dekriminalizimit si më sipër.

Të nderuar anëtar të KAS, subjekti zgjedhor dhe njëkohësisht me cilësinë e ankuesit brenda periudhës së ngushtë në dispozicion për të siguruar provat në mbështetje të pretendimeve, ka drejtuar shkresat zyrtare për të marrë informacionin e nevojshëm. Në kushtet kur informacioni i kërkuar disponohet nga institucione publike, të qeverisjes, qendrore dhe vendore është i vështirë për tu siguruar kërkojmë nga ana juaj të administroni të plotë dokumentacionin shkresor dhe filmik në fjalë duke e kërkuar drejtpërdrejt nga institucioni pranë të cilit gjendet.

Përveç shkeljeve të ligjit të konsumuara gjatë procesit në QV-të e sipërcituara në këtë zonë zgjedhore janë konsumuar edhe shkelje të rënda të ligjit zgjedhor në procedin e numërimit ku pothuajse për cdo QV të numëruar rezultati i dalë dhe i pasqyruar në tabelat e numërimit nuk pasqyron saktësisht rezultatin e dalë nga procesi i numërimit. Kjo është konstatuar nga ana jonë nga krahasimi i rezultateve të mbajtura nga vëzhguesit tanë me ato të tabelave të secilit grup të numërimit të votave të cilat për shkak se tabuloheshin dhe hidheshin në sistem me vonesë na viheshin në dispozicion me vonesë neve si subjekt zgjedhor.




- Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni Bashkë Fitojmë, kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjes me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në ZAZ-në 45. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë se numrit të votave të vlefshme, apo të përfshira si vota të vlefshme për një tjetër kandidat, është relativisht i lart. Nga

leximi i këtyre anomalive apo parregullsive në kualifikimin jo të rregullt të votës, rezulton se Kandidatit të Koalicionit duhet t'i shtohen të paktën votat për të cilin ai ka humbur mandatin, kjo sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e ZAZ.

- Pra natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme këqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final rinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi, ku nga leximi i materialit filmik, konstatohet qartë se vota e Kandidatit të Koalicionit është shpërdoruar dhe adresuar qëllimshëm në një tjetër kandidat, dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.
- Për të përforcuar këtë qëndrim të bazuar të Koalicioni ankues, në interesin më të lartë të procesit zgjedhor që ka të bëjë me numërimin e votave të kësaj Bashkie, janë administruar tabelat përmbledhëse dhe libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se si dhe cdo dokument tjetër që vërteton pretendimet tona. Nga këto dokumente konstatohet se nga përmbajtja e vendimmarrjeve të çdo KZAZ-je rezultojnë parregullsi të shumta të cilat kanë cenuar procesin e votimit, të numërimit, të identifikimit korrekt të votës, nëpërmjet ndërhyrjeve që janë bërë me qëllim tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore.
- Këto veprime vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe procedurat e caktuara në aktet e Komisionit Rregullator pranë KQZ dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sa i përket pasqyrimin real dhe të vërtetë të vullnetit të zgjedhësve. Kjo rrethanë përbën shkak ligjor sipas parashikimeve të nenin 160 dhe provon se vendimi i KZAZ-se që të kundërshtojmë dhe gjithë procedura e mëpasshme që përfundon me miratimin e tabelës përmbledhëse nga KQZ janë marrë në kundërshtim të hapur me ligjin.
- Ankuesi kërkon nga KAS që për nevoja të hetimit administrativ, ky organ kolegjal të vendosi të administrojë si prova Librin e Protokollit të Mbledhjeve, Proces-Verbalet e Konstatimit, të KZAZ objekt ankimi, tabelat e rezultatit të grupeve të numërimit për QV të e cituara na ankim, pamjet filmike të VNV-ve, QV-VE dhe vetë ZAZ-së si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për një hetim administrativ të plotë dhe të paanshëm.
- Kërkesa e Ankuesit për rinumërim dhe rivlerësim, gjen mbështetje në nenin 138 të Kodit Zgjedhor, dhe në mënyrë të qartë mbështetet në prova të cilat pasqyrojnë se gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave sipas përcaktimeve të nenit 116, 119 të Kodit Zgjedhor ka pasur shkelje të konstatuara për numërim jo të saktë të votave për çdo kandidat, dhe për më tepër nga aktet e VNV-KZAZ gjatë vlerësimit të votave ka pasur kundërshtim nga ndonjë prej anëtarëve të grupeve të numërimit apo vëzhguesve të Koalicionit apo subjekteve të tjera që kanë kontestuar parregullsi. Po sipas procedurave të përcaktuara në nenin 116, pika 6 dhe 118 të Kodit zgjedhor këto kontestime pasqyrohen në dokumentacionin zgjedhor si kundër është Procesverbali i Konstatimit, aktet e zaz-së dhe Libri i Protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së.
- Pavarësisht dokumentacionit të sipërpërmendur, materiali zgjedhor që do të nxirret nga pamjet filmike në shumë raste krijon dhe do të krijoj dyshime të arsyeshme se vlerësimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë nga grupet e numërimit.
- Gjithashtu, Ankuesi vlerëson se transparencë në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore nr. 45 Bashkia Belsh, ka një rëndësi të madhe për besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij. Për sa koha Koalicioni nga dokumentacioni ka konstatuar parregullsi, lindin dyshime të arsyeshme se në disa qendra votimi objekt ankimi, vota nuk është vlerësuar saktë, dhe nevoja imediate që lind për transparencë të procesit të numërimit për këto Qendra Votimi, duhet domosdoshmërisht të bindi anëtarët e KAS të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet e paraqitura nga Ankuesi nëpërmjet rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë e votimit të qendrave të votimit, KZAZ-së 45, sipas parashtrimeve të Kërkesës Ankimore.




Nënshkrimi i Ankuesit



- Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: **“Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtuar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i Ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara”,** dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 “Këqyrja e materialit zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, **KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV-të sipas objektit të ankimit.**
- Për sa i përket këtyre shkeljeve, të cilat i provojmë me pamjet filmike ku janë shkelur në mënyrë flagrante nenet 116, 117, 118, 119 të Kodit Zgjedhor, KQZ bazuar në material provues të rivlerësoje votat në qendrat e votimit të kërkuara më sipër. Pasi të kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre kutive të votimit, KQZ të hartojë dhe të miratojë tabelën përmbledhëse përfundimtare duke shfuqizuar vendimin nr. 533 datë 18.05.2023 të KSHZ, lidhur me miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit në Bashkinë Belsh.

NË LIDHJE ME PAVLEFSHMËRINË E ZGJEDHJEVE


Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë. Konkretisht, neni 160 parashikon se KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Një vendimmarrje e tillë, sipas neni 121, pika 1 është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.

Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve: a) shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore; b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë. 3. Shkaqet sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës pararendëse kanë lidhje vetëm me procesin e votimit, kurse shkaqet sipas shkronjës “a” kanë lidhje me procesin në përgjithësi (përfshirë votimin dhe rezultatin e zgjedhjeve).

Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkakun themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur,




 Nënshkrimi i Ankuesit



por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.

Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik. Sipas pikës 2 të këtij neni “ndikim në ndarjen e mandateve në zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme. Shkeljet e renditura si, babai I kandidatit polic burgu, edukatoret anëtar te QV, te propozuar nga subjekti qe propozon kandidatin, Drejtori i burgut këshilltari I drejtuesit politike te qarkut së partisë që propozon kandidatin, janë shkaqe të padiskutueshme qe provojnë detyrim e zgjedhësve të dënuar të qendrës së posaçme në IEVP Belsh që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, kur diferenca midis kandidatëve është vetëm 40.

Në këtë rast faktet dhe provat te cilat për pamundësi objektive nuk mundëm ti sigurojmë por ti evidentojmë qarte, për tu kërkuar institucionalisht nga KQZ, përmbushin kushtin se provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.

Shkeljet e pretenduara, që shërbejnë si indicia për rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në Qendrat e votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Belsh.

Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjej me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në ZAZ-në 45. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultonte se numri i votave të vlefshme të kandidatit tonë z. Bedri Qypi të cilat janë vlerësuar si të pavlefshme ose nuk janë përfshirë në numrin e votive të vlefshme të tij është relativisht i lartë. Pra natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme rinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi, ku nga informacionet që disponojmë konstatohet qartë se vota e Kandidatit të Koalicionit është shpërdoruar dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.

Ankuesi kërkon nga KAS që për nevoja të hetimit administrativ, ky organ kolegjal të vendosi të administrojë si prova Librin e Protokollit të Mbledhjeve, Proces-Verbalet e Konstatimit, të KZAZ objekt ankimi, tabelat e rezultatit të grupeve të numërimit për QV të e cituara na ankim, pamjet filmike të VNV-ve, QV-VE dhe vetë ZAZ-së si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për një hetim administrativ të plotë dhe të paanshëm.




Nënshkrimi i Ankuesit

Kërkesa e ankuesit për rinumërim dhe rivlerësim, gjen mbështetje në nenin 138 të Kodit Zgjedhor, dhe në mënyrë të qartë mbështetet në prova të cilat pasqyrojnë se gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave sipas përcaktimeve të nenit 116, 119 të Kodit Zgjedhor ka pasur shkelje të konstatuara për numërim jo të saktë të votave për çdo kandidat, dhe për më tepër nga aktet e VNV-KZAZ gjatë vlerësimit të votave ka pasur kundërshtim nga ndonjë prej anëtarëve të grupeve të numërimit apo vëzhguesve të Koalicionit apo subjekteve të tjera që kanë kontestuar parregullsi. Po sipas procedurave të përcaktuara në nenin 116, pika 6 dhe 118 të Kodit zgjedhor këto kontestime pasqyrohen në dokumentacionin zgjedhor si kundër është Procesverbali i Konstatimit, aktet e KZAZ-së dhe Libri i Protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së.

Pavarësisht dokumentacionit të sipërpërmendur, materiali zgjedhor që do të nxirret nga pamjet filmike në shumë raste krijon dyshime të arsyeshme se vlerësimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë nga grupet e numërimit.

Gjithashtu, ankuesi vlerëson se transparenca në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore Bashkia Belsh, ka një rëndësi të madhe për besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij. Për sa kohë ankuesi nga dokumentacioni ka konstatuar parregullsi, lindin dyshime të arsyeshme se në disa qendra votimi objekt ankimi, vota nuk është vlerësuar saktë, dhe nevoja imediate që lind për transparencë të procesit të numërimit për këto Qendra Votimi, duhet domosdoshmërisht të bindi anëtarët e KAS të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet e paraqitura nga ankuesi nëpërmjet rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë e votimit të qendrave të votimit, KZAZ-së 45, sipas parashtrimeve të Kërkesës Ankimore.

Në përputhje me parashikimet e nenit **136, pika 3 të Kodit Zgjedhor**, ku parashikohet shprehimisht se: *“Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara”*, dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 “Këqyrja e materialit zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV-të sipas objektit të ankimit.

Për sa i përket këtyre shkeljeve, të cilat i provojmë me pamjet filmike ku janë shkelur në mënyrë flagrante nenet 116, 117, 118, 119 të Kodit Zgjedhor, KQZ bazuar në material provues të rivlerësoje votat në qendrat e votimit të kërkuara më sipër. Pasi te kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre kutive të votimit, KQZ të hartojë dhe të miratojë tabelën përmbledhëse përfundimtare duke shfuqizuar vendimin nr. 532 datë 18.05.2023 të KQZ.

Në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërimit.


Nënshkrimi i Ankuesit

KONKLuzion

Sa më sipër kërkohet:



1. Kundërshtimin e Vendimit Nr. 533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për Organet Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023” ;
2. Rinumërimin dhe Rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore, Bashkia Belsh dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh duke përfshirë në të rezultatit e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave;
3. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh;
4. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Belsh, duke mos përfshirë rezultatit e qendrës së votimit nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë.
5. Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi.

PROVAT QË PARAQITEN DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.

1. Vendimi nr. 533 datë 18.05.2023 i KSHZ objekt ankimi ;
2. Kopje e vendimeve të lejimit për votim të të burgosurve në IEVP Kosovë/Lushnje, pjesë e zgjedhjeve në Belsh ;
